



Planuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivery	10.10.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKMShCK	6481/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A nr. 1150/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1150/2023 të datës 07.09.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.10.2023, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar A.nr.1150/2023 e datës 07.09.2023 e parashtruar nga ankuesi,

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 846 i datës 09.08.2023 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m.

(tani e tutje referuar si ankues), i cili sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës së Punësimit" në Rahovec, me datë 07.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6006 të regjistruar nën shenjen A.nr.1150/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 846 të datës 09.08.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.09.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencia e Punësimit, ndërsa me datë 12.09.2023, nga kjo e fundit ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (Kolegji i Këshillit), administroi këto prova: Ankesën A.nr.1150/2023 të datës 07.09.2023, drejtuar KPMSHC-së; Vendimi me numër protokolli 846 të datës 09.08.2023 të DBNJ/ARK; Konkursin e datës 13.06.2023; Aplikacionin e kandidatit Arsim Kastrati, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër Nr.1511 të datës 22.05.2012; Certifikatën e datës 11.10.2017; Certifikatën e muajt dhjetor të vitit 2015; Certifikatën e datës 04.03.2019; Vërtetim me numër protokolli 108/2016 të datës 29.01.2016; Akt Emërimit me numër protokolli 3113 të datës 02.09.2015; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022; Vërtetimi me numër protokolli 471 të datës 19.04.2023; Vendimi me numër protokolli 803 të datës 01.08.2023 të DBNJ/ARK; Vendimin me numër protokolli 804 të datës 01.08.2023 të DBNJ/ARK; Njoftimin me numër protokolli 806 të datës 01.08.2023 të Njesisë se Burimeve Njerëzore; Ankesën e datës 03.08.2023, drejtuar Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës; Njoftimin me numër protokolli 847 të datës 09.08.2023 të Njesisë se Burimeve Njerëzore; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1150/2012 të datës 12.09.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, me datë 13.06.2023 (afati për aplikim 21.07.2023 – 28.07.2023) ka shpallur konkursin për ngritje në detyrë lidhur me pozitën e punës “Udhëheqës i Zyrës së Punësimit” në Rahovec, me numër të referencës RN00011808. Rrjedhimisht, sipas Vendimit 803 të datës 01.08.2023, rezulton se ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë për të vazhduar me fazat tjera të konkursit për pozitën përkatëse të punës, për shkak të aplikacionit të pakompletuar. Ankuesi i pakënaqur me Vendimin 803 të datës 01.08.2023 ka parashtruar ankesë pranë Njesisë se Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit, ndërsa kjo e fundit me Vendimin me numër 846 të datës 09.08.2023 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me arsyetimin e njëjtë se pala ankuese me rastin e aplikimit nuk ka bashkangjitur dy vlerësimet e rezultateve të punës për dy vitet e fundit, respektivisht i njëjti ka dorëzuar vetëm Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, ndërsa atë të vitit 2021 nuk e ka ofruar si dëshmi, si dhe nuk ka ofruar dëshmi që nuk ka masë disiplinore (jo me të vjetër se data e njoftimit të këtij konkursi).

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore analizoi kriteret e konkursit për pozitën përkatëse të punës dhe për pasojë konstatoi se kriteret formale për pozitën e punës “Udhëheqës i Zyrës së Punësimit” në Rahovec, me numër të referencës RN00011808, kanë qenë:

- *Arsimi i Kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë; se paku 3 vite të studimeve në shkencat Ekonomike, Juridike apo Sociale;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Se paku (3) vite përvoja pune në pozitën e një kategorie me të ulët;*
- *Nëpunësi të jetë vlerësuar të paktën mirë për rezultatet individuale në punë, gjate dy viteve të fundit përpara konkurrimit për ngritje në detyrë; Në rastin e vlerësimit të rezultateve individuale shumë mirë apo shkëlqyeshëm për dy vitet e fundit, nëpunësi mund të aplikoj për ngritje në detyrë edhe nëse ka vetëm dy vite punë në kategorinë me të ulët.*

Po ashtu, konkursi i shpallur ka përmbajtur edhe klauzolën lidhur me dokumentet që duhet të dorëzojnë kandidatet, gjegjësisht sipas shpalljes së konkursit së bashku me aplikacion është kërkuar të dorëzohet: *Kopja e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; Kopjet e dëshmisë se punësimit; Kopjet e dëshmisë se trajnimeve; Kopje të vlerësimit të punës për dy vitet e fundit; Dokument që*

dëshmon se kandidati nuk ka mase disiplinore të parashikuara nga nën paragrafi 1.3 i nenit 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, masë disiplinore që nuk është shuar ende (dokumenti duhet të ketë datën jo më të vjetër se data e njoftimit të këtij konkursi).

Sipas dosjes së lëndës rezultoi se ankuesi me rastin e aplikimit, lidhur me plotësimin e kriterit të kualifikimit, ka dorëzuar Diplomën me numër 1511 të datës 22.05.2012 me të cilën vërtetohet se i njëjti me datë 23.03.2012 ka përfunduar studimet themelore - Bachelor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, si dhe Certifikatën me numër Ref.Nr.03- 17/222 të datës 11.10.2017 me të cilën vërtetohet se kandidati në fjalë me datë 28.06.2017 ka përfunduar studimet Master në të Drejtën Penale. Ndërsa sa i përket kriterit të përvojës së punës i njëjti ka dorëzuar Vërtetimin me numër protokollit Vr.Nr.108/2016 të datës 29.01.2016 të lëshuar nga Oda e Avokateve të Kosovës, me të cilën dëshmohet se ankuesi nga data 30.01.2015 deri me datën 29.01.2016 ka vijuar stazhin e praktikantit pranë Zyrës së Avokatit B. Krasniqi në Prishtinë, si dhe Aktin e emërimit me numër protokollit 01.Nr.3113 të datës 02.09.2015 të lëshuar nga Komuna e Rahovecit, me të cilën vërtetohet se ankuesi nga data 04.09.2015 është i punësuar me afat të pacaktuar në pozitën e punës "Zyrtar për Kulturë" pranë Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.

Kolegji i Këshillit nga analizimi dhe shqyrtimi i shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi me rastin e aplikimit ka dorëzuar po ashtu edhe Vërtetimin me numër protokollit 471 të datës 19.04.2023 me të cilin i njëjti dëshmon se nuk ka asnjë masë disiplinore të shqiptuar nga organi punëdhënës, mirëpo ky vërtetim është lëshuar me datë 19.04.2023, ndërsa konkursi ishte publikuar me datë 13.06.2023, nga rrjedh se vërtetimi nuk është lëshuar pas datës së publikimit të konkursit ashtu siç është kërkuar në shpalljen e konkursit, sikurse ankuesi me asnjë provë nuk ka mundur të dëshmojë se me rastin e aplikimit ka dorëzuar, përveç formularit të vlerësimit të punës për vitin 2022, edhe atë të vitit 2021.

Me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 53 (kushtet dhe kërkesat për ngritjen në detyrë) është përcaktuar se: 1. Për të aplikuar për ngritjen në detyrë, personi duhet të plotësojë së bashku, kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2. Kushtet për ngritjen në detyrë janë: 2.1. nëpunësi të ketë të paktën tre (3) vjet pune në pozitën e një kategorie më të ulët. Në rastin e procedurës për ngritjen në detyrë në një pozitë të kategorisë të ulët drejtuese, periudha e punës provuese llogaritet si kohë e përvojës në punë; 2.2. nëpunësi të mos jetë ndëshkuar me masë disiplinore të parashikuara nga nën paragrafi 1.3 i neni 47 të Ligjit, që nuk është shuar ende; 2.3. nëpunësi të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet individuale në punë, gjatë dy (2) viteve të fundit para konkurrimit për ngritje në detyrë. 3. Në rastin e vlerësimit të rezultateve individuale "shumë mirë" apo shkëlqyeshëm për dy vitet e fundit, nëpunësi mund të aplikojë për ngritje në detyrë edhe nëse ka vetëm dy (2) vite punë në kategorinë më të ulët, andaj duke u bazuar në kuadrin ligjor si më lartë Kolegji i Këshillit konstaton se organi i punësimit, respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Punësimit ka zbatuar drejt ligjin material me rastin e përcaktimit të kriterëve formale në konkursin e shpallur për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës së Punësimit" në Rahovec", me numër të referencës RN00011808, dhe si rrjedhojë kjo e fundit me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, ashtu sikurse edhe me rastin e vendosjes për refuzimin e ankesës si të pa bazuar, ngase edhe përkundër faktit se organi i punësimit në shpallje të konkursit ka specifikuar dokumentet të cilat duhet të dorëzohen nga të gjithë kandidatët të cilët aplikojnë në konkurs, duke theksuar po ashtu së dokumenti që dëshmon se kandidati nuk ka mase disiplinore të parashikuara nga nën paragrafi 1.3 i nenit 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, nuk duhet të jetë me i vjetër se data e

njoftimit të këtij konkursi), ankuesi ka dështuar të kompletoj aplikacionin e tij me dokumentet e kërkuara, gjegjësisht ka dorëzuar Vërtetimin me numër protokoll 471 të datës 19.04.2023 me të cilin i njëjti dëshmon se nuk ka asnjë masë disiplinore të shqiptuar nga organi punëdhënës, me të vjetër se sa data e shpalljes së konkursit (13.06.2023), dhe po ashtu i njëjti me asnjë provë nuk ka mundur të mbështes pretendimin e tij se me rastin e aplikimit ka dorëzuar edhe formularin e vlerësimit për vitin 2022.

Andaj, për sa me sipër rrjedh se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me mos përfshirjen e tij në listën e ngushtë janë të paqëndrueshme ngase Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Punësimit, si njësi përgjegjëse, ka zbatuar drejt ligjin material me rastin e nxjerrjes së Vendimit 803 të datës 01.08.2023 për refuzimin e aplikacionit të ankueses si të pakompletuar, ashtu sikurse edhe me rastin e refuzimit të ankesës si të pa bazuar me Vendimin me numër 846 të datës 09.08.2023, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 15 paragrafët 1, 2 dhe 3, ndërlidhur me nenin 53 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1150/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit.
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

